



**INSTITUTI I KURRIKULAVE DHE I TRAJNIMIT**

**PROGRAMET E KURRIKULËS ME ZGJEDHJE TË DETYRUAR  
TË GJIMNAZIT**

**FUSHA: SHKENCA SHOQËRORE**

**LËNDA: HISTORI**

**KODI: 8.2.11.Z**

**PROGRAMI I LËNDËS HISTORI E QYTETËRIMIT BOTËROR**

**PËR KLASËN E 11<sup>të</sup>**

**TIRANË, DHJETOR 2009**

Programi “Historia e qytetërimit botëror”, studion të gjitha aspektet e jetës shoqërore si shteti, ligji, ekonomia, jeta sociale dhe kultura materiale e shpirtërore, duke vendosur një raport të barabartë midis këtyre fushave të jetës

Historia e qytetërimit botëror ka për qëllim, përgatitjen e nxënësve për të qenë qytetarë të informuar të botës, të aftë për të ndërvepruar me individë dhe grupe individësh të kulturave të ndryshme, si dhe të aftë për të kuptuar të kaluarën, të sotmen dhe perspektivat e së ardhmes.

Programi “Historia e Qytetërimit Botëror” (avancuar), shpreh risi për problematikën që ai sjell dhe mënyrën e trajtimit, në krahasim me kurikulën e mëparshme të arsimit të mesëm. Ai synon që të krijojë te nxënës-i/ja bindjen se qytetërimi i sotëm është një vazhdimësi progresive e qytetërimit të hershëm, pra e sotmja e ka burimin tek e kaluara dhe është e lidhur me të.

Kronologjia është kriteri kryesor i kësaj kurikule, e cila zbaton parimin shkencor historik të zhvillimit të ngjarjeve mbi lidhjen shkak – pasojë dhe vazhdimësinë progresive të rrjedhës historike.

Nga ana tjetër, përdorimi i kriterit tematik krijon mundësi për të përzgjedhur ngjarjet më të spikatura dhe sinjifikative të qytetërimit botëror. Kjo i jep programit natyrën përzgjedhëse (selektive), pasi ai nuk ka si qëllim të mbulojë gjithë ngjarjet e historisë së qytetërimit botëror, gjë që do të sillte një ngarkesë të panevojshme për nxënësin, por të trajtojë problemet thelbësore, modelet historike që përbëjnë rrënjët e qytetërimit të sotëm. Trajtesa tematike ka pasur parasysh dhe vendosjen e një balance historike mes kontributeve të shoqërive në lindjen dhe zhvillimin e qytetërimit botëror, duke shprehur vlerat e tyre në një këndvështrim të barabartë.

Ky program e ndihmon nxënësin që të kuptojë më mirë realitetin e sotëm dhe ngjarjet aktuale që ndodhin, t’i analizojë ato në mënyrë kritike, duke bërë lidhjen e së sotmes me të shkuarën historike dhe me perspektivat e së ardhmes. Programi shpalos hapësira që i japin mundësi nxënësit për t’u përfshirë në ato fusha ku ai dëshiron të thellohet.

## **1. SYNIMI I LËNDËS**

Lënda “Historia e qytetërimit botëror” synon:

- Të njohë nxënësit me qytetërimet botërore, etapat e zhvillimit dhe vlerat e tyre.
- Të aftësojë nxënësit për të ndërvepruar me individë dhe grupe individësh të kulturave të ndryshme, për të njohur të kaluarën, për të kuptuar ndërveprimin e saj me të sotmen dhe me perspektivat e së ardhmes, duke nxënë, analizuar dhe menduar në mënyrë kritike.
- Të zhvillojë aftësitë intelektuale të nxënësit për të analizuar dhe për të interpretuar informacionin historik në mënyrë kritike.
- Të aftësojë nxënësit për t’u bërë qytetarë aktivë dhe të përgjegjshëm në dimensionet lokale, kombëtare, rajonale, e globale duke ju mundësuar atyre ndërtimin e identitetit individual dhe kolektiv përmes njohjes së trashëgimisë historike të përbashkët.

- Të ngrejë vlerat themelore të qytetarisë si tolerancën, mirëkuptimin, të drejtat e njeriut dhe demokracinë.

## **2. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM**

- Të përshkruajë momentet më kulmore të zhvillimit të shoqërisë njerëzore, nëpërmjet një trajtimi kronologjik-tematik.
- Të përshkruajë përvojën historike të shoqërisë njerëzore, për të kuptuar më mirë jetën aktuale dhe për të qenë të aftë të projektojnë të ardhmen, duke nxitur tek nxënësit të menduarin në mënyrë kritike.
- Të interpretojë ngjarjet e shoqërisë njerëzore në të kaluarën, për të kuptuar nxënësit të sotmen dhe ndikimin e tyre në zhvillimet historike të së ardhmes.
- Të edukojë nxënësit me ndenjen e mirëkuptimit dhe të besimit të ndërsjellë midis popujve, nëpërmjet studimit të kulturës, të shkëmbimeve të shumanshme dhe të trashëgimisë.
- Të argumentojë vlerat e trashëgimisë historike, duke e vlerësuar këtë trashëgimi si pjesë të përcaktimit të identitetit të një populli.
- Të aftësojë nxënësit për punë kërkimore, nëpërmjet teknikave alternative, duke nxjerrë veçoritë e vendeve dhe popujve të ndryshëm.
- Të krijojë mundësi për punë kërkimore, duke u bazuar në burime historike, për studimin e ngjarjeve të ndryshme të historisë.
- Të edukojë te nxënësi frymën argumentuese përballë tezave të ndryshme rreth një fenomeni historik.
- Të evidentojë pozitën e qytetërimit shqiptar si pjesë e qytetërimeve botërore.
- Të zhvillojë te nxënësit përmes studimit të historisë vlera pozitive si: toleranca dhe respektimi i dallimeve ndërmjet kulturave të ndryshme.
- Të zhvillojë te nxënësit përmes studimit të historisë aftësitë qytetare, të cilat kontribuojnë në rritjen e tyre personale si individë, në përgatitjen e tyre për në jetë, në punë dhe në shoqëri.
- Të edukojë te nxënësit detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre në kuadrin e shtetit ligjor, të mbrojtjes së të drejtave dhe të lirive të individit, nëpërmjet pajisjes me kulturë demokratike.

## **3. OBJEKTIVA SIPAS LINJAVE DHE NËNLINJAVE**

**36 javë x 2 orë = 72 orë**

### **HISTORIA E QYTETËRIMIT BOTËROR**

#### **“QYTETËRIMET NË ANTIKITET DHE NË MESJETË”**

**Linja 1**

**Qytetërimet e Lashta (mijëvjeçarin III – I para.K.)**

### Përshkrimi i linjës

Kjo linjë ka për qëllim të paraqesë një pamje të qytetërimit në Azinë e Mesme e të Largët (Kinë, Indi, Japoni) gjatë mijëvjeçarit III – I Para.K. Linja synon të formojë te nxënësit koncepte të qarta shkencore mbi qytetërimet në këto rajone me të gjitha aspektet jetësore: ekonomike, shoqërore, politike e kulturore dhe të argumentojë vlerat e tyre. Nxënësit duhet të jenë të aftë të krijojnë lidhjen mes qytetërimeve, të tregojnë kontributet e këtyre qytetërimeve në zhvillimin e mëvonshëm të shoqërisë së këtyre vendeve, duke treguar se qytetërimi i sotëm e ka filluesin në qytetërimin e hershëm. Nxënës/i,-ja në këtë linjë do të kuptojë se rrënjët e sistemeve të sotme politike, filozofike, fetare, juridike, e kanë burimin e tyre në qytetërimet e hershme. Nxënës/i,-ja në këtë mënyrë arrin të plotësojë njohuritë e marra në programin e kurrikulës bërthamë, duke krijuar një tablo të plotë mbi qytetërimet e tjera botërore.

**Orë të sugjeruara<sup>1</sup>:** 15 orë

Nënlinja	Objektiva
<b>Qytetërimi antik aziatik dhe tiparet e tij</b>	<i>Në përfundim të klasës së 11-të nxënës/i,-ja:</i> <ul style="list-style-type: none"><li>▪ <u>të përdorë saktë</u> termat dhe konceptet historike kyçe: kasta, shoqëri e mbyllur;</li><li>▪ <u>të përcaktojë</u> në hartë shtrirjen e qytetërimeve në Kinë, Indi dhe Japoni;</li><li>▪ <u>të argumentojë</u> rolin e mjedisit në veçoritë e jetës ekonomike në Kinë, Indi dhe Japoni;</li><li>▪ <u>të analizojë</u> veçoritë e zhvillimit ekonomik në Kinë, Indi dhe Japoni;</li><li>▪ <u>të përshkruajë</u> ndërtimin shoqëror në Kinë, Indi dhe Japoni;</li><li>▪ <u>të tregojë</u> elementet e jetës së përditshme në Kinë, Indi dhe Japoni;</li></ul>
<b>Shteti në qytetërimet antike aziatike</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>▪ <u>të përdorë saktë</u> termat dhe konceptet historike kyçe: dinasti, mbretëri, perandori;</li><li>▪ <u>të përshkruajë</u> rrugën e formimit të shtetit në Kinë, Indi dhe Japoni;</li><li>▪ <u>të krahasojë</u> veçoritë e shtetformimit në Kinë, Indi dhe Japoni;</li><li>▪ <u>të listojë</u> disa nga dinastitë kryesore në Kinë, Indi dhe Japoni;</li></ul>
<b>Filozofia dhe ligji (rregullat) në qytetërimet antike.</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>▪ <u>të përdorë saktë</u> konceptet historike kyçe: ligji, legjislacioni, juria, sistemi legal;</li><li>▪ <u>të listojë</u> disa nga parimet e filozofisë së Konfucit;</li><li>▪ <u>të analizojë</u> ndikimin e konfucianizmi në</li></ul>

<sup>1</sup> Orë të sugjeruara janë orët e planifikuara nga specialistët për zhvillimin e linjës. Shuma totale e orëve të linjave duhet të jetë sa numri i plotë i orëve në planin mësimor për këtë lëndë. Quhen të sugjeruara, sepse i jepet liri zbatuesit të programit (mësuesit), që të shtojë ose të pakësojë numrin e sugjeruar të orëve në masën 10%, sipas nevojave të klasës.

	<p>sistemin ligjore në Kinë;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <u>të analizojë</u> ndikimin e parimeve të budizmit në organizimin shtetëror në Indi;</li> <li>▪ <u>të përshkruajë</u> veçoritë e sistemit ligjor në Japoni;</li> <li>▪ <u>të dallojë</u> veçoritë dhe të përbashkëta në sistemet ligjore në Perandoritë e Azisë Qendrore dhe Lindore;</li> </ul>
<p><b>Trashëgimia kulturore e qytetërimeve antike (Kinë, Indi, Japoni).</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <u>të përdorë saktë</u> konceptet historike kyçe: brahmanizmi, budizmi, konfucianizmi, politeizmi, monoteizmi, judaizmi, kristianizmi, sekt fetar;</li> <li>▪ <u>të shpjegojë</u> përmbajtjen e politeizmit dhe shkaqet e krijimit të tij;</li> <li>▪ <u>të zbulojë</u> veçoritë e besimeve në Azinë lindore e jugore;</li> <li>▪ <u>të vlerësojë</u> rolin e figurave kryesore historike si p. sh.: Buda, Konfuci, në formimin e ndërgjegjes fetare dhe morale të qytetërimeve antike (Indi, Kinë, Japoni);</li> <li>▪ <u>të analizojë</u> vlerat që solli shkrimi, duke përshkruar evolucionin dhe veçoritë e tij;</li> <li>▪ <u>të vlerësojë</u> kontributin që dha shkenca, arsimi, letërsia dhe arti antik i Kinës, Indisë e Japonisë, në zhvillimin e shoqërisë njerëzore;</li> <li>▪ <u>të përcaktojë</u> parimet themelore të besimit monoteist të hebrenjve;</li> <li>▪ <u>të analizojë</u> influencën e besimit në mënyrën e jetesës në këto qytetërime;</li> <li>▪ <u>të vlerësojë</u><sup>2</sup> shkallën e përdorimit të njohurive, shprehive, aftësive dhe qëndrimeve, që zotëron nxënësi për qytetërimet antike të Azisë Qendrore dhe Lindore;</li> </ul>
<p><b><i>Veprimtari praktike të sugjeruara</i></b><sup>3</sup>:</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <u>të analizojë</u> ndikimin që kishte familja dhe komuniteti në qytetërimet antike;</li> </ul>

<sup>2</sup> Ky objektivi shërben për matjen dhe vlerësimin e njohurive, të shprehive dhe të qëndrimeve të fituara nga nxënësit për qytetërimet në antikitet. Mund të realizohet nga mësuesi nëpërmjet një testi ose një ore përsëritjeje, por duhet theksuar se testi nuk është i detyrueshëm për t'u zhvilluar nga.

<sup>3</sup> Veprimtari praktike të sugjeruara janë orë praktike në funksion të përpunimit dhe thellimit të njohurive të reja, si dhe të aftësisë praktik të nxënësve. Këto veprimtari praktike janë dhënë për çdo nënlinjë, duke u ndarë në raportin 30% veprimtari praktike, kundrejt 70% njohuri të reja. Janë të sugjeruara, sepse përdoruesit e programit (hartuesit e tekstit dhe mësuesit) mund t'i ndryshojnë këto veprimtari të sugjeruara, në funksion të nevojave të përpunimit të lëndës dhe të përshtatjes së këtyre veprimtarive me ngjarjet e reja në kohë. Në rubrikën veprimtari praktike të sugjeruara mund të jenë dhënë më shumë se 30% tema veprimtarish praktike, që i përkasin një linje për përpunimin e njohurive. Përdoruesit e programit duhet të përzgjedhin në masën 30 %, ato veprimtari që i mendojnë më të përshtatshme për përpunimin e objektivave të linjës dhe të nënlinjës.

<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Familja farefisnia dhe komuniteti në qytetërimet gjatë antikitetit në Kinë, Indi e Japoni.</li> <li>▪ Ndërtoni albumin tuaj të qytetërimeve antike të Azisë Qendrore e Lindore, mbështetur mbi ngjarjet kryesore.</li> <li>▪ Paraqitni format e organizimit shtetëror në qytetërimet e Kinës, Indisë e Japonisë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <u>të mbledhë</u> të dhëna të ndryshme për qytetërimet antike të Kinës, Indisë e Japonisë dhe të krijojë një album për to;</li> <li>▪ <u>të dallojë</u> format e ndryshme të qeverisjes në qytetërimet antike të Azisë Qendrore e Lindore, duke i paraqitur ato në mënyrë skematike.</li> </ul>
--	--

## Linja 2

### Qytetërimet mesjetare – urë lidhëse në mes qytetërimit antik dhe atij modern (shek. VI-XV).

#### Përshkrimi i linjës

Kjo linjë ka për qëllim të paraqesë dhe të qartësojë veçorinë e qytetërimit mesjetar, natyrën e tij të dyfishtë: si një periudhë, në të cilën ndërpritet shkëlqimi i qytetërimit antik, por dhe si periudhë pararendëse e qytetërimit modern. Nxënës/i,-ja në këtë linjë do të vlerësojë feudalizmin si një rend i ri me veçoritë e tij ekonomike, politike e sociale; lindjen e qyteteve si një proces që krijon kushte për kalimin e shoqërisë mesjetare drejt një shoqërie moderne. Nxënës/i,-ja do të përforcojë njohuritë mbi rolin e fesë e të institucioneve fetare gjatë mesjetës, si dhe zbehjen graduale të tyre në raport me zhvillimin e pandërprerë të shkencës, artit dhe kulturës. Nxënës/i,-ja do të diskutojë mënyrën se si periudha e mesjetës i hapi rrugë njohjes globale të botës, si dhe lindjes e qytetërimit modern.

Orë të sugjeruara: 15 orë

Nënlinja	Objektiva
<p><b>Mesjeta në vendet aziatike: Kinë, Indi, Japoni (shek. VI-XIV)</b></p>	<p><i>Në përfundim të klasës së 11-të nxënës/i,-ja:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <u>të përdorë saktë</u> termat dhe konceptet kyçe historike, si: feudalizëm, vasalë, fisnikë, samuraj, kodi i etikës, neokonfucianizëm;</li> <li>▪ <u>të përcaktojë</u> në hartë përhapjen e feudalizmit në Botë;</li> <li>▪ <u>të dallojë</u> tiparet e mesjetës në Kinë, Indi, Japoni;</li> <li>▪ <u>të përshkruajë</u> jetën e shoqërisë mesjetare në vendet aziatike;</li> <li>▪ <u>të argumentojë</u> rolin dominues të besimit si tipar</li> </ul>

	<p>dallues i qytetërimit mesjetar;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <u>të krahasojë</u> tiparet e feudalizmit në Evropë me tiparet që mori ai në Azinë Lindore.</li> </ul>
<p><b>Qytetërimi bizantin (shek. VI-XV)</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <u>të përdorë saktë</u> termat dhe konceptet kyçe historike, si: kohë e artë, rit universalizëm, katolik, ortodoks, ikonoklazëm;</li> <li>▪ <u>të zbulojë</u> tiparet e epokës Justiniane dhe vlerat e saj;</li> <li>▪ <u>të argumentojë</u> thelbin e ikonoklazmës dhe lidhjen e saj me politikën;</li> <li>▪ <u>të analizojë</u> faktorët historikë që sollën një periudhë prosperiteti (lulëzimi) në Perandorinë Bizantine;</li> <li>▪ <u>të argumentojë</u> përparimin kulturor të kësaj periudhe;</li> </ul>
<p><b>Lindja dhe zhvillimi i qyteteve në Mesjetë dhe rrjedhjat ekonomike, sociale e politike. (shek. XI-XIV)</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <u>të përdorë saktë</u> termat dhe konceptet historike kyçe, si: komunë, esnafë, gilde, saraf;</li> <li>▪ <u>të përcaktojë</u> në hartë qytetet bregdetare në Itali, Gjermani, Francë, si dhe rrugët tregtare ndërkombëtare;</li> <li>▪ <u>të shpjegojë</u> shndërrimin e pellgut të Mesdheut në mesjetë si kryqëzim i qytetërimit bizantin, arab dhe evropian;</li> <li>▪ <u>të dallojë</u> faktorët që sollën transformimet në fushën ekonomike pas shek. XI;</li> <li>▪ <u>të listojë</u> fenomenet ekonomike sociale që sollën zhvillimin e qyteteve;</li> <li>▪ <u>të përshkruajë</u> jetën e një qyteti: artizanatin, tregtinë, financat si elementet thelbësore të jetës qytetare;</li> <li>▪ <u>të analizojë</u> shkaqet e konflikteve ndërmjet qytetit dhe feudit;</li> <li>▪ <u>të analizojë</u> veçoritë që mori qyteti i shpallur komunë;</li> <li>▪ <u>të përshkruajë</u> fillesat e tregtisë ndërkontinentale;</li> <li>▪ <u>të shpjegojë</u> arsyet e përfshirjes së qyteteve bregdetare në tregtinë ndërkontinentale;</li> </ul>
<p><b>Besimi, arsimi, shkenca dhe arti gjatë qytetërimit mesjetar.</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <u>të përdorë saktë</u> termat dhe konceptet historike kyçe, si: kristianizmi, islamizmi, skizma, shi'it, syni, katolicizëm, ortodoksi;</li> <li>▪ <u>të shpjegojë</u> si lindën krishtërimi dhe myslimanizmi;</li> <li>▪ <u>të evidentojë</u> shtyllat kryesore të kristianizmit dhe të myslimanizmit;</li> <li>▪ <u>të vlerësojë</u> skizmat e ndryshme dhe lidhjen e tyre me jetën politike dhe shoqërore;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <u>të argumentojë</u> kthesën që pësoi arsimi në mesjetë;</li> <li>▪ <u>të analizojë</u> kushtet historike që sollën përparimin e shkencës;</li> <li>▪ <u>të argumentojë</u> nevojën e transformimit të përmbajtjes së shkollës dhe të zhvillimit të shkencës;</li> <li>▪ <u>të vlerësojë</u> shkallën e përdorimit të njohurive, shprehive, aftësive dhe të qëndrimeve që zotëron nxënësi për qytetërimin mesjetar, duke evidentuar lidhjen e tij me qytetërimin antik;</li> </ul>
<p><b><i>Veprimtari praktike të sugjeruara:</i></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Qytetërimi si koncept dhe fryma evolutive e tij.</li> <li>▪ Territoret arbërore nën sistemin feudal bizantin.</li> <li>▪ Tiparet shtetformuese të arbërve në periudhën e Bizantit (Principata e Arbrit).</li> <li>▪ Qytetërimi mesjetar aziatik dhe Evropa.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <u>të argumentojë</u> evolucionin e konceptit qytetërim;</li> <li>▪ <u>të grumbullojë</u> materiale mbi shtrirjen e sistemit feudal bizantin në territoret arbërore dhe tiparet e tij;</li> <li>▪ <u>të evidentojë</u> mënyrën e administrimit të territoreve arbërore në periudhën e Bizantit;</li> <li>▪ <u>të diskutojë</u> mbi rëndësinë e Principatës së Arbrit dhe tiparet shtetformuese të arbërve</li> <li>▪ <u>të hartojë</u> një ese përshkuese me temë: “Qytetërimi mesjetar aziatik dhe Evropa”.</li> </ul>

### **OYTETËRIMET MODERNE DHE BASHKËKOHORE**

#### **Linja 3**

#### **Jeta në qytetet evropiane para dhe gjatë periudhës së industrializimit (shek. XV-XX)**

#### **Përshkrimi i linjës**

Kjo linjë pasqyron procesin e kalimit nga shoqëria agrare në atë industriale në Evropë. Në këtë linjë nxënësit do të njihen me lindjen e shoqërisë industriale dhe fenomenet që e shoqëruan atë si: revolucionet në fushën e teknologjisë, tregtisë, komunikacionit, të cilat morën shkallë-shkallë përhapje globale. Nxënësit mësojnë sesi transformimet e mëdha industriale u shoqëruan me probleme sociale, që gjetën pasqyrim në idetë e teoritë e reja mbi natyrën, njeriun, shoqërinë dhe perspektivat e tyre.

**Orë të sugjeruara:** 8 orë



Nënlinja	Objektivat
<p><b>Jeta qytetare në Evropë në periudhën paraindustriale dhe industriale (shek. XV-XX)</b></p>	<p><i>Në përfundim të klasës së 11-të nxënës/i,-ja:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <u>të përdorë saktë</u> konceptet historike kyçe: urbanizim, lëvizje demografike, sindikatë, marksizëm, socialdemokraci;</li> <li>▪ <u>të analizojë</u> ndryshimet në qytetet evropiane në shek. XV-XVI;</li> <li>▪ <u>të përshkruajë</u> shndërrimin e qyteteve evropiane në qytete industriale;</li> <li>▪ <u>të listojë</u> tiparet e qyteteve industriale në Evropë;</li> <li>▪ <u>të përshkruajë</u> procesin e urbanizimit të qyteteve industriale;</li> <li>▪ <u>të vlerësojë</u> ndryshimet demografike që solli lindja e qyteteve industriale;</li> <li>▪ <u>të analizojë</u> ndryshimet sociale dhe shtresëzimet që krijoi periudha industriale;</li> <li>▪ <u>të gjykojë</u> anët pozitive dhe negative të industrializimit të qyteteve;</li> </ul>
<p><b>Epoka e mekanizimit dhe lindja e ideve të reja politike (shek. XIX-XX)</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <u>të shpjegojë</u> kushtet në të cilat lindën sindikatat;</li> <li>▪ <u>të analizojë</u> rolin e tyre në lëvizjen punëtore;</li> <li>▪ <u>të dallojë</u> ndryshimin midis sindikatave dhe partive punëtore;</li> <li>▪ <u>të listojë</u> parimet e partive socialdemokrate në Evropë (dhe rrymave të majta të përhapura në Evropë);</li> <li>▪ <u>të shpjegojë</u> kushtet e lindjes së marksizmit;</li> <li>▪ <u>të përshkruajë</u> idetë kryesore të marksizmit (të paraqitura në Manifestin komunist);</li> <li>▪ <u>të analizojë</u> ndikimin e ideve të Marksit në lëvizjen punëtore;</li> <li>▪ <u>të dallojë</u> marksizmin nga ideologjia e socialdemokracisë evropiane;</li> <li>▪ <u>të vlerësojë</u> figurat kryesore historike: Karl Marksi, Roza Luksemburgu;</li> <li>▪ <b>të vlerësojë</b> shkallën e përdorimit të njohurive, shprehive, aftësive dhe të qëndrimeve që zotëron nxënësi mbi qytetërimin modern;</li> </ul>
<p><b><i>Veprimtari praktike të sugjeruara:</i></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përpyqjet për modernizimin dhe evropianizimin e jetës shqiptare gjatë viteve 20-</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <u>të grumbullojë</u> materiale për mënyrën e jetesës në Shqipëri gjatë viteve 20-30 të shek. XX;</li> <li>▪ <u>të analizojë</u> tiparet themelore të jetës ekonomike-sociale;</li> <li>▪ <u>të evidentojë</u> (përpyqjet për zhvillimin e kapitalizmit në Shqipëri) tiparet e degëve të reja</li> </ul>

<p>30 të shek. XX.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Industritë e reja dhe rritja e nivelit të jetesës.</li> <li>▪ Tiparet e lëvizjes punëtore në Shqipëri në vitet 20-30 të shek. XX.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ industriale;</li> <li>▪ <u>të përshkruajë</u> fillimet e lëvizjes punëtore në Shqipëri në vitet 20-30 të shek. XX;</li> <li>▪ <u>të vlerësojë</u> ndikimin e zhvillimit industrial në nivelin e jetesës.</li> </ul>
--	--

#### Linja 4

#### Qytetërimet aziatike në kohët moderne (shek. XV-XIX)

##### Përshkrimi i linjës

Kjo linjë pasqyron lindjen dhe përhapjen e kolonializmit dhe qytetërimin në Lindjen e Mesme dhe të Largët (Kinë, Indi, Japoni) gjatë shek. XV-XVII. Nxënësit njihen me ekspansionin evropian, rrugët e realizimit të këtij procesi, lindjen e arterieve të reja tregtare, krijimin e kolonive, si dhe hapat e parë të depërtimit evropian në këtë rajon. Nxënësit do të zbulojnë veçoritë e mjedisit si dhe ndikimin e tij në organizimin e jetës ekonomike, politike, shoqërore. Nxënësit do të njihen me pozitën e gruas në qytetërimin modern aziatik. Përgjatë kësaj linje nxënësit do të diskutojnë dhe argumentojnë vlerat, rolin dhe kontributet e qytetërimin aziatik në zhvillimin e qytetërimin botëror.

Orë të sugjeruara: 15 orë

Nënlinja	Objektivat
<p><b>Lindja dhe përhapja e kolonializmit (shek. XV-XVIII)</b></p>	<p><i>Në përfundim të klasës së 11-të nxënës/i,-ja:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <u>të përdorë saktë</u> konceptet historike kyçe: kolonializëm, koloni, koloni tregtare, kasta e tregtarëve, sistem tributar, komunë, shogun, samuraj, reformat Mej, izolim, evropianizim, neokonfucianizëm, hapje, modernizëm;</li> <li>▪ <u>të shpjegojë</u> krijimin e kolonive të para pas Zbulimeve të Mëdha Gjeografike;</li> <li>▪ <u>të analizojë</u> krijimin e kolonive të para si fillim i procesit të kolonializmit;</li> <li>▪ <u>të listojë shtetet koloniale gjatë shek. XV-XVIII;</u></li> <li>▪ <u>të përcaktojë</u> në hartë shtrirjen gjeografike të kolonive;</li> <li>▪ <u>të analizojë</u> shkallën e zhvillimit të shoqërisë në <u>vendet koloniale dhe vlerat ekonomike të këtyre vendeve.</u></li> </ul>
<p><b>Lindja e Mesme dhe e Largët gjatë kohës së ekspansionit evropian në Azi</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <u>të përcaktojë</u> në hartë rajonet ku u vendosën për të parën herë evropianët në Azi;</li> <li>▪ <u>të përshkruajë</u> fazat e ekspansionit evropian në</li> </ul>

<p><b>(shek. XV – XVII)</b></p>	<p>vendet aziatike;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <u>të përshkruajë</u> tiparet e qytetërimit aziatik gjatë kohës moderne;</li> <li>▪ <u>të dallojë</u> të përbashkëtat dhe të veçantat e qytetërimit aziatik në shtete të ndryshme;</li> <li>▪ <u>të listojë</u> karakteristikat e ekonomisë kineze gjatë periudhës së ekspansionit evropian;</li> <li>▪ <u>të shpjegojë</u> ndryshimet që pësoi Kina nën dinastinë mançure Çin;</li> <li>▪ <u>të listojë</u> karakteristikat e ekonomisë indiane në fillim të shek. XVI;</li> <li>▪ <u>të evidentojë</u> tiparet e kastës së tregtarëve në Indi;</li> <li>▪ <u>të listojë</u> karakteristikat e ekonomisë japoneze para unifikimit të Japonisë;</li> <li>▪ <u>të shpjegojë</u> ndryshimet në politikat ekonomike të dinastisë japoneze të Tokugajve;</li> </ul>
<p><b>Tradita në Lindjen e Mesme dhe të Largët dhe transformimi i saj (shek. XVII-XIX)</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <u>të argumentojë</u> arsyet e rilindjes së traditave të lashta në Kinë;</li> <li>▪ <u>të përcaktojë</u> parimet e neokonfucianizmit;</li> <li>▪ <u>të evidentojë</u> shkallën e ndikimit të filozofisë në jetën politike dhe shoqërore;</li> <li>▪ <u>të ilustrtojë</u> tiparet e jetës qytetare në Kinë dhe Japoni;</li> <li>▪ <u>të evidentojë</u> komunën në Kinë si njësi bazë ekonomike dhe organizimi shoqëror;</li> <li>▪ <u>të evidentojë</u> statusin dhe rolin e gruas në shoqëritë kineze dhe japoneze;</li> <li>▪ <u>të paraqesë</u> në mënyrë grafike strukturën shoqërore në Japoni dhe Kinë;</li> <li>▪ <u>të krahasojë</u> jetën rurale me atë urbane në Kinë dhe Japoni;</li> <li>▪ <u>të analizojë</u> ndryshimet që pësoi shoqëria indiane gjatë qeverisjes së Akbarit;</li> <li>▪ <u>të vlerësojë</u> zhvillimin kulturor dhe arsimor në Indi, Kinë dhe Japoni;</li> <li>▪ <u>të rendisë</u> shkaqet e Luftës së Opiumit midis Kinës dhe britanikëve;</li> <li>▪ <u>të nxjerrë</u> përfundime mbi pasojat e Luftës së Opiumit;</li> <li>▪ <u>të identifikojë</u> rrugët e modernizimit të Japonisë.</li> <li>▪ <u>të rendisë</u> reformat e ndërmarra në Japoni gjatë shek. XIX;</li> <li>▪ <u>të analizojë</u> reagimin e shoqërisë në vendet e Azisë Qendrore dhe Lindore për politikën e hapjes së këtyre shteteve ndaj qytetërimit perëndimor;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <u>të përshkruajë</u> prirjet politike të vendeve të Azisë Qendrore dhe Lindore deri në përfundim të Luftës së Dytë Botërore;</li> <li>▪ <b>të vlerësojë</b> shkallën e përdorimit të njohurive, shprehive, aftësive dhe qëndrimeve që zotëron nxënësi mbi qytetërimet botërore, gjatë kohës së ekspansionit evropian në Azi (shek. XV – XVII);</li> </ul>
<p><b>Veprimtari praktike të sugjeruara:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Zhvendosja e tregut botëror nga oqeani Atlantik drejt oqeanit Paqësor.</li> <li>▪ Shoqëritë tradicionale në Azi përballë misionarëve katolikë evropiane.</li> <li>▪ Jeta e britanikëve (dhe ndikimi i tyre në shoqërinë indiane) në Indi.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <u>të grumbullojë</u> materiale dhe të analizojë shkaqet dhe pasojat e zhvendosjes së tregut nga oqeani Atlantik drejt atij Paqësor;</li> <li>▪ <u>të gjykojë</u> mbi shkallën e ndikimit të misionarëve katolikë evropianë në shoqëritë tradicionale në Azinë Qendrore dhe Lindore;</li> <li>▪ <u>të përpilojë</u> një tablo të jetës së britanikëve në Indi;</li> <li>▪ <u>të nxjerrë</u> përfundime mbi marrëdhëniet e anglezëve me shtresat e larta indiane;</li> <li>▪ <u>të analizojë</u> shkaqet e rritjes së nacionalizmit ekstrem në Japoni dhe rrjedhojat e tij.</li> </ul>

## Linja 5

## Qytetërimet bashkëkohore (gjysma e dytë e shek. XX)

### Përshkrimi i linjës

Në këtë linjë nxënësit do të njihen me ndryshimet që ndodhën gjatë shekullit XX si: ngjallja e plotë e Evropës, konsolidimi i demokracisë në shtetet perëndimore, emancipimi i Azisë, Afrikës, ringritja e Japonisë, rënia e regjimeve komuniste në Evropën Lindore dhe Qendrore dhe pasojat e tyre. Nxënësit do të mësojnë se fundi i shek. XX, krahas zhvillimit të madh teknologjik, i solli botës edhe konfrontime të mëdha shoqërore, që u shkaktuan nga kufizimi i burimeve globale, mbipopullimi, terrorizmi, luftërat rajonale, ngrohja globale etj. Nxënësit do të diskutojnë përpjekjet që bëhen, apo duhen bërë për kapërcimin e këtyre sfidave të shek. XXI.

**Orë të sugjeruara:** 19 orë

Nënlinja	Objektivat
<b>Konsolidimi i demokracisë liberale në shtetet e Evropës Perëndimore (1945-1990)</b>	<p><i>Në përfundim të klasës së 11-të nxënës/i,-ja:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <u>të përdorë saktë</u> konceptet historike kyçe: demokraci liberale, ekonomi mikse, shtet i mirëqenies sociale, forca nacionaliste, komuniste,</li> </ul>

	<p>marshimi i madh, revolucion kulturor, Luftë e Ftohtë, bipolarizim, dekolonizim, gandizëm, shtete të paangazhuara, globalizëm, terrorizëm, ngrohje globale, krim i organizuar;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ të përshkruajë tiparet e reja të zhvillimeve ekonomike dhe politike në disa nga shtetet e Evropës Perëndimore;</li> <li>▪ të analizojë përhapjen dhe konsolidimin e demokracisë liberale në shtetet e Evropës Perëndimore pas Luftës së Dytë Botërore;</li> <li>▪ të shpjegojë tiparet e shtetit të mirëqenies sociale dhe zbatimin e tij në shtetet e Evropës Perëndimore;</li> </ul>
<p><b>Ndryshimet në qytetërimet në Kinë dhe Japoni mbas Luftës së Dytë Botërore (1945-1990)</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ të listojë shkaqet e zhvillimit të Luftës civile në Kinë midis forcave nacionaliste të Çan Kai Shisë dhe komunistëve të Mao Ce Dunit;</li> <li>▪ të përshkruajë ardhjen në pushtet të regjimit komunist të Mao Ce Dunit;</li> <li>▪ të analizojë tiparet e komunizmit kinez;</li> <li>▪ të përshkruajë kushtet në të cilat filloi Revolucioni i Madh Kulturor kinez;</li> <li>▪ të gjykojë mbi synimet e Revolucionit të Madh kinez;</li> <li>▪ të përshkruajë ndryshimet në mënyrën e jetesës dhe shoqërinë kineze gjatë regjimit komunist;</li> <li>▪ të krahasojë komunizmin kinez me atë të Evropës Lindore;</li> <li>▪ të përshkruajë gjendjen e Japonisë në përfundim të Luftës së Dytë Botërore;</li> <li>▪ të analizojë ndikimin e shteteve perëndimore në zhvillimet ekonomike të Japonisë së pasluftës;</li> <li>▪ të shpjegojë reformat çmilitarizuese dhe demokratike të ndërmarra nga Mak Arturi në Japoni pas Luftës së Dytë Botërore;</li> <li>▪ të evidentojë faktorët që çuan në zhvillimin e ekonomisë japoneze;</li> <li>▪ të përshkruajë mënyrën e jetesës në Japoninë e pas Luftës së Dytë Botërore;</li> </ul>
<p><b>Lëvizjet nacionaliste në vendet koloniale</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ të përshkruajë faktorët që çuan në lëvizjet çlirimtare në vendet koloniale;</li> <li>▪ të shpjegojë procesin e lindjes dhe forcimit të ndërgjegjes kombëtare në vendet koloniale;</li> <li>▪ të përcaktojë rrugët e zhvillimit të procesit të dekolonizimit të botës dhe lindjen e shteteve nacionale;</li> <li>▪ të vlerësojë rolin e Mahatma Gandit në krijimin e shtetit nacional indian;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <u>të listojë</u> tipologjinë e regjimeve në shtetet post-koloniale;</li> <li>▪ <u>të analizojë</u> faktorët që çuan në lëvizjen e shteteve të paangazhuara;</li> <li>▪ <u>të listojë</u> qëllimet e lëvizjes së shteteve të paangazhuara;</li> <li>▪ <u>të gjykojë</u> mbi rëndësinë e lëvizjes së shteteve të paangazhuara në qytetërimin botëror;</li> </ul>
<p><b>Përfundimi i Luftës së Ftohtë dhe sfidat e reja të qytetërimeve Botërore</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <u>të analizojë</u> zbatimin e modelit të demokracisë liberale në shtetet ish-komuniste të Evropës Qendrore dhe Lindore;</li> <li>▪ <u>të evidentojë</u> vështirësitë që janë hasur në zbatimin e tij;</li> <li>▪ <u>të analizojë</u> përfundimet dhe pasojat e luftërave civile me karakter etnik në shtetet ish-komuniste;</li> <li>▪ <u>të shpjegojë</u> ndikimin e komunitetit ndërkombëtar në zgjidhjet e konflikteve me karakter etnik në Ballkan;</li> <li>▪ <u>të evidentojë</u> tiparet e luftës kundër terrorizmit;</li> <li>▪ <u>të përshkruajë</u> zhvillimet në luftën kundër terrorizmit pas 11 shtator 2001;</li> <li>▪ <u>të përcaktojë</u> problemet që lidhen me ngrohjen globale dhe hapat që janë marrë për reduktimin e këtij fenomeni;</li> <li>▪ <u>të listojnë</u> disa nga vendimet e Samitit për tokën të mbajtur në Brazil në vitin 1992;</li> <li>▪ <u>të rendisë</u> disa nga hapat e ndërmarra nga organizma të ndryshëm ndërkombëtarë për problemet mjedisore;</li> <li>▪ <u>të vlerësojë</u> shkallën e përdorimit të njohurive, shprehive, aftësive dhe të qëndrimeve që zotëron nxënësi mbi qytetërimin bashkëkohor;</li> </ul>
<p><b><i>Veprimtari praktike të sugjeruara:</i></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Frontet kombëtare e veçoritë e tyre gjatë Luftës së Dytë Botërore.</li> <li>▪ Shqipëria dhe tranzicioni.</li> <li>▪ Dukuritë e globalizmit gjatë Historisë Botërore.</li> <li>▪ Globalizmi sot: tendencat, pasojat dhe raporti i tij me nacionalizmin.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ <u>të mbledhë</u> të dhëna mbi rezistencën kundër pushtuesit në disa shtete të Evropës (Francë, Greqi, Shqipëri, Jugosllavi, etj.);</li> <li>▪ <u>të diskutojë</u> në klasë mbi vështirësitë që ka hasur Shqipëria në tranzicionin e saj (nga diktatura komuniste) drejt demokracisë dhe ekonomisë së tregut;</li> <li>▪ <u>të mbledhë</u> të dhëna mbi globalizmin gjatë historisë së qytetërimit botëror;</li> <li>▪ <u>të krijojë</u> një ese argumentuese mbi marrëdhëniet e nacionalizmit me globalizmin.</li> </ul>

#### 4. KËRKESA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Ky program është një dokument zyrtar, pjesë e tërësisë së dokumenteve zyrtare në lëndën “Historia e qytetërimit botëror”. Dokumente të tjera kryesore janë plani mësimor i gjimnazit, korniza kurrikulare e gjimnazit, standardet e fushës kurrikulare, ku kjo lëndë bën pjesë, programi i kurrikulës bërthamë përkatësisht për klasën e 10-të dhe të 11-të të gjimnazit. Hartimi i programit të avancuar është mbështetur te korniza kurrikulare, standardet e fushës, si dhe te programi bërthamë i klasës` së 10-të dhe të 11-të .

Për të siguruar përdorimin sa më të mirë të programit, është e vlefshme njohja me dokumentet e lartpërmendura.

Te korniza kurrikulare vëmendje e veçantë i duhet kushtuar:

- synimeve të përgjithshme të kurrikulës së gjimnazit;
- synimeve të linjave ndërkurrikulare;
- vlerësimit të nxënësit me notë;
- parimeve të mësimdhënies-mësimnxënies.

Në mënyrë që tërësia e dokumenteve zyrtare (korniza kurrikulare, standardet e fushës së të nxënësve dhe programi lëndor) të zbatohen më së miri në dobi të nxënësve, përdoruesit e tyre duhet të njohin thellë programet lëndore të lëndës “Historia e qytetërimit botëror” për klasën paraardhëse dhe klasat pasardhëse.

Gjithashtu, përdoruesve të këtyre dokumenteve u lind nevoja të njohin standardet e të gjitha fushave të tjera të të nxënësve dhe të gjitha programet lëndore të të njëjtit vit.

Zbatimi i programit duhet të bëhet duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore dhe fetare.

#### Objektivat e programit

Objektivat e programit janë për të gjithë nxënësit. Kjo do të thotë se të gjithë nxënësve duhet t’u jepet mundësia që të nxënë çka përshkruhet tek objektivat. Realizimi i objektiveve në tema, kapituj e njësi dhe renditja e tyre është zgjedhje e lirë e zbatuesit të programit.

#### Orët mësimore

Programi “Historia e qytetërimit botëror”, i avancuar për klasën e 11-të, ka natyrë tematike-kronologjike dhe është strukturuar në linja dhe nënlinja, që vijnë njëra pas tjetrës. Linja nënkupton tematika të gjera historike, ndërsa nënlinjat nënkuptojnë zbërthimin e këtyre tematikave (linjave) në kapituj (nënlinja).

Programi i avancuar i “Historisë së Qytetërimit Botëror” për **klasën e 11-të** trajton **“Historinë e Qytetërimeve Antike, Mesjetare, Moderne dhe Bashkëkohore ”**, që zhvillohen në **72 orë mësimore vjetore**, prej të cilave: **47 orë njohuri të reja, 17orë veprimtari praktike dhe 8 orë përpunim njohurish**, pra në raportin 70% njohuri të reja kundrejt 30% veprimtari praktike.

Në programin e **avancuar** të “Historisë së Qytetërimit Botëror” për klasën e 11-të nxënësit zgjerojnë njohuritë e marra më parë në kurrikulën bërthamë mbi “Historinë e Qytetërimit Botëror”, duke zgjeruar konceptet historike mbi qytetërimin botëror.

Veprimtaritë praktike shërbejnë për t’u ardhur në ndihmë nxënësit dhe mësuesit në orët e përpunimit, me raste sugjerimi për çështje të ndryshme historike, në lidhje me thellimin dhe përpunimin e njohurive dhe të shprehive të fituara në lëndën e historisë, duke e vënë nxënësin në qendër për mbledhjen dhe interpretimin e informacionit.

Nëpërmjet veprimtarive praktike duhet të integrohet historia e qytetërimit të popullit shqiptar me historinë e qytetërimit botëror, duke inkuadruar ngjarjet e historisë së popullit shqiptar në ngjarjet e historisë botërore, nëpërmjet periodizimit të historisë.

Sasia e orëve mësimore për secilën linjë është rekomanduese. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës; ata janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën linjë. Domethënë, mësuesi mund të vendosë të përparojë më ngadalë, kur vë re se nxënësit e tij hasin vështirësi të veçanta në përmbushjen e objektivave të nënlinjës, por mund të ecë më shpejt, kur nxënësit e tij demonstrojnë një përvetësim të kënaqshëm.

Në programin e lëndës “Historia e qytetërimit botëror” afërsisht **70%** e orëve mësimore totale janë për shtjellimin e njohurive të reja lëndore dhe **30%** e tyre janë për përpunim njohurish, nëpërmjet veprimtarive praktike, përsëritjeve dhe testeve.

## **Përpunimi i njohurive**

Përpunimi i njohurive përmban:

- përsëritjen brenda një kapitulli të njohurive bazë të tij (konceptet themelore);
- testimin e njohurive bazë;
- integrimin e njohurive të reja të një kapitulli me njohuritë e kapitujve paraardhës;
- integrimin e njohurive të reja me njohuritë e lëndëve të tjera (ndonëse këto integrame do të përshkojnë zhvillimin e çdo ore mësimore, gjatë përpunimit atyre u duhet kushtuar kohë e posaçme);
- përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit gjatë paraqitjes së punëve praktike, debatit në klasë, përgatitjes së temave të veçanta të vetë nxënësve, paraqitjes me anë të një projektori të hartave të ndryshme apo ngjarjeve të rëndësishme në histori, përdorimi i DVD-së për të treguar ngjarje reale që kanë lidhje me tema të veçanta mësimore si Lufta e Dytë Botërore, rrëzimi i Murit të Berlinit etj;
- projekte kurrikulare lëndore;
- përsëritjen vjetore (pavarësisht nga ndarja në linja ose në kapituj, lënda duhet parë si një e tërë);
- testimin vjetor (nuk është i detyruar).

Në orët mësimore që i përkasin përpunimit të njohurive, mësues/i,-ja zhvillon edhe tema me nismën e tij/saj ose me kërkesën e vetë nxënësve. Këto tema mund të pikënisen nga ngjarje aktuale ose thjesht nga kureshtja e nxënësve.

Gjatë përpunimit të njohurive duhet t’i kushtohet kohë e posaçme veçanërisht kultivimit të:



- aftësive të përgjithshme, si: aftësia e komunikimit, e menaxhimit të informacionit, e zgjidhjeve problemore, e të menduarit kritik dhe krijues;
- aftësive të posaçme lëndore, si: forcimi i personalitetit, edukimi i karrierës, aftësia për të vendosur në kohë dhe hapësirë ngjarjet historike, aftësia për të kuptuar, analizuar dhe argumentuar lidhjet shkak–pasojë, aftësia për të hetuar, interpretuar ngjarje historike, aftësia për të përdorur teknologjinë e informacionit si mjet burimor, aftësia për punë kërkimore, punë në grup etj.

Gjatë orëve të përpunimit të njohurive nxënësve duhet t’u krijohet mundësia të realizojnë detyra tematike, veprimtari praktike e projekte kurrikulare, të zgjidhin situata problemore nga jeta etj.

Pjesë e përpunimit të njohurive është rishqyrtimi vjetor, i cili ka për qëllim të nxjerrë në pah konceptet dhe të përforcojë shprehitë dhe qëndrimet e nxënësve.

## 5. VLERËSIMI

Vlerësimi i nxënës/it,-es përkrahon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënës/it,-es nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat e programit lëndor dhe mësues/i,-ja nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ata objektiva të arritjes, që nuk përshkruhen në program.

Objektiv i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe shprehitë, por edhe qëndrimet e nxënësve, si qëndrimet etike-sociale, në përgjithësi dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, në veçanti.

Mësues/i,-ja i historisë vlerëson me notë apo me stimul shkallën dhe dinamikën e pjesëmarrjes së nxënësve në procesin mësimor. Mësues/i,-ja, gjithashtu, vlerëson saktësinë e informacionit të paraqitur nga nxënës/i,-ja, aftësinë e tij/saj për të diskutuar, debatuar, krahasuar, argumentuar dhe parashikuar, duke mbajtur qëndrimin e tij/saj personal ndaj një ngjarjeje apo figure të caktuar historike. Në lëndën e historisë mësues/i,-ja duhet të vlerësojë aftësinë e nxënësve për të punuar në grup dhe për të vlerësuar nga secili nxënës punën e anëtarëve të tjerë të grupit.

Mësues/i,-ja i/e historisë duhet të vlerësojë përdorimin e burimeve alternative nga nxënësit, ballafaqimin e tyre dhe forcën argumentuese ndaj një çështjeje të diskutueshme ose të debatueshme në histori. Kriter vlerësimi për nxënësit në lëndën e historisë është dhe përfshirja e tyre në debat, duke respektuar mendimet e kundërta të njëri-tjetrit, të bazuara mbi argumente ose fakte historike.

Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Nxënës/i,-ja vlerësohet me notë, ndërsa demonstron arritjet e tij/saj me gojë, me shkrim, ose nëpërmjet veprimtarish e produktesh të tjera, si: veprimtari praktike, raste studimore, shkrimi i një eseje, prodhimi i një CD-je, hartimi i një maketi për një ngjarje apo figurë të caktuar historike, projekte etj.

Në punime të nxënësve me grupe të vogla, mësues/i,-ja parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të secilit nxënës në veçanti.

Mësues/i,-ja nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimore dhe të vendosë nota në regjistër për secilën orë mësimore. Si rregull, nxënësit

dhe mësuesit duhet të bashkëbisedojnë lirshëm, si partnerë rreth përvetësimit të njohurive të fituara në orët e kaluara dhe kryerjes mirë të detyrave jashtë klase.

Herë pas here mësues/i,-ja duhet të vlerësojë me notë, duke ua bërë të qartë nxënësve që në fillim qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij.

Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin e komunikimit me shkrim dhe mund të realizohet jo vetëm me laps e letër, por edhe në rrugë elektronike.

Mësues/i,-ja e vlerëson nxënësin me notë për parashtrimet me shkrim në provimet periodike me shkrim dhe në prezantimet me shkrim të punimeve të tij, të zhvilluara vetë ose në grup.

Mësues/i,-ja planifikon provime periodike me shkrim për blloqe të gjera orësh mësimore që përbëhen nga një a disa kapituj, të cilët i bashkojnë objektiva të ndërlidhur të të nxënësit. Në përshtatje me qëllimin e vlerësimit me shkrim, ai/ajo përdor lloje të ndryshme testesh, që nga minitestet pakminutëshe për një objektivi të veçantë të nxënësit, tek ato njëorëshe; teste me alternativë ose me zhvillim; detyra tematike, projekte kurrikulare etj. Një formë e parashtrimit me shkrim nga nxënësit është dhe provimi përfundimtar.

Portofoli i nxënës/it,-es, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij/saj përgjatë vitit shkollor për një lëndë të caktuar. Ai mund të përmbajë provime me shkrim, detyra tematike, projekte kurrikulare, fotografi e produkte të veprimtarive kurrikulare, tabelë kronologjike të ngjarjeve ose të një periudhe historike, CD, dokumentar mbi një ngjarje historike, biografi për histori gojore, postera, albume, ese, artikuj publicistikë etj.

Portofoli i përngjet një albumi me anën e të cilit mësues/i,-ja, nxënës/i,-ja vetë dhe prindërit e tij/saj gjejnë informacion të shpejtë dhe të sintetizuar rreth progresit të nxënësit. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësit, mësues/i,-ja rekomandon.